



Organizata [“Të Ndryshëm &Të Barabartë ” \(D&E\)](#) dhe “Instituti NEXUS” dhe kanë publikuar tre udhëzues riintegrimi për profesionistët që eksplorojnë çështjet kryesore në mbështetjen dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit:

- Fazat e rikuperimit dhe riintegrimit të viktimave të trafikimit
- Mbështetja e fëmijëve të viktimave të trafikimit
- Mentorimi i viktimave të trafikimit

Audienca e synuar është një gamë e gjerë profesionistësh të riintegrimin në Shqipëri, si punonjës socialë, asistentë social, psikologë dhe këshillues, punonjës të mbrojtjes së fëmijëve, ofrues të kujdesit shëndetësor, avokatë dhe jurist, staf të strehëzave, administratorë publikë, mësues dhe drejtues shkollash, profesionistë që punojnë në fuqizimin ekonomik, etj. Udhëzuesit do të jenë gjithashtu ndihmues për profesionistët e riintegrimin në vende të tjera, të cilët këto mjete dhe burime praktike do u shërbejnë në punën e tyre të përditshme.

Çdo udhëzues riintegrimi është një burim i pavarur për profesionistët e riintegrimin për t’a përdorur në punën e tyre të përditshme. Udhëzuesit mund të përdoren për të përgatitur dhe trajnuar profesionistët, si dhe mund të referohen gjatë punës së vazhdueshme të riintegrimin.

Seria e udhëzuesve të riintegrimin u hartua nga “Të Ndryshëm &Të Barabartë” (D&E) dhe Instituti NEXUS në kuadër të projektit [“Ofrimi i Shërbimeve Gjithëpërfshirëse të Riintegrimin dhe Përmirësimi i Kuadrit të Mbrojtjes për Viktimat e Trafikimit në Shqipëri”](#)

Këto udhëzues bazohen në dy dekada të punës riintegruese në Shqipëri, si dhe në përvojat e viktimave të trafikimit dhe ofrojnë udhëzime se si të adresohen çështjet dhe pengesat kryesore.

Udhëzuesit u rishikuan dhe u validuan nga profesionitë ekspertë nga institucione shtetërore dhe organizata të shoqërisë civile në Shqipëri në dhjetor të vitit 2021. Ato janë në dispozicion në gjuhën anglisht dhe shqip.



[Fazat e rikuperimit dhe riintegritimit të viktimave të trafikimit. Një udhëzues riintegrimi për praktikuesit](#)

Rikuperimi dhe riintegrimi pas një përvoje trafikimi është larg nga një tranzicion i lehtë ose i qetë. Shpesh është një proces kompleks dhe i ndërlikuar që përfshin sfida të rëndësishme për viktimat, si dhe anëtarët e familjes së tyre dhe i cili ndikohet nga mjediset e familjes dhe komunitetit në të cilat ato riintegrohen. Ky udhëzues riintegrimi përshkruan tre fazat e rikuperimit dhe riintegritimit të viktimave të trafikimit – 1) faza e krizës, 2) faza e tranzicionit dhe 3) faza e riintegritimit dhe përfshirjes – bazuar në përvojat e viktimave të trafikimit dhe profesionistëve të riintegritimit në Shqipëri. Udhëzuesi fillon me një shpjegim të riintegritimit, duke përshkruar tre fazat e riintegritimit. Më pas hyn në detaje të mëtejshme për secilën nga fazat, duke ofruar një pasqyrë të fazës specifike, ndjenjat dhe sjelljet e viktimave në këtë fazë, dhe çfarë ndihme dhe mbështetje zakonisht nevojitet dhe ofrohet në këtë fazë. Çdo seksion më pas përfundon me një listë kontrolli me sugjerime për profesionistët e riintegritimit si udhëzim për punën e tyre të përditshme.



[Mbështetja e fëmijëve të viktimave të trafikimit. Një udhëzues riintegrimi për profesionistët.](#)

Deri më sot, pak vëmendje i është kushtuar riintegrimin të fëmijëve të viktimave të trafikimit. Këta fëmijë – ata që mbetën pas, ata që janë trafikuar me prindërit e tyre dhe ata të lindur nga një situatë trafikimi – përballen me sfida serioze dhe të ndryshme, jo vetëm kur prindi i tyre trafikohet, por edhe pas përfundimit të trafikimit dhe janë në proces rikuperimi dhe riintegrimi. Po kështu, ofruesit e shërbimeve përballen me një sërë kufizimesh për të mbështetur në mënyrë efektive sigurinë, mirëqenien dhe riintegrimin afatgjatë të këtyre fëmijëve, jo më pak duke pasur parasysh kompleksitetin dhe shumëllojshmërinë e nevojave të tyre për ndihmë. Bazuar në përvojat e viktimave të trafikimit dhe profesionistëve të riintegrimin në Shqipëri, ky udhëzues riintegrimi ofron një kuptim të zgjeruar të përvojave dhe nevojave të fëmijëve të viktimave të trafikimit, për të mbështetur në mënyrë efektive dhe të përshtatshme përfshirjen e këtyre fëmijëve në familjet dhe komunitetet e tyre dhe për të siguruar akses në të drejtat dhe mundësitë që u takojnë dhe që janë jetike për zhvillimin e tyre të shëndetshëm. Ai ofron udhëzime dhe sugjerime për profesionistët e riintegrimin për t'i mbështetur ata në punën e tyre të përditshme me fëmijët e viktimave të trafikimit dhe familjet e tyre.



[Mentorimi i viktimave të trafikimit. Një udhëzues riintegrimi për profesionistët](#)

Rikuperimi dhe riintegrimi pas trafikimit është një proces kompleks dhe i ndërlikuar që përfshin sfida të rëndësishme për viktimat, si dhe për anëtarët e familjeve të tyre. Ofruesit e shërbimeve luajnë një rol të rëndësishëm dhe ndonjëherë jetëshpëtues në mbështetjen për rikuperimin dhe riintegrimin e tyre. Këtu përfshihen mentorët që u ofrojnë viktimave të trafikimit mbështetje emocionale dhe sociale, shërbejnë si një

model pozitiv dhe një shembull i një marrëdhënieje të shëndetshme dhe mbështetëse. Mentorët gjithashtu punojnë me viktimat e trafikimit për të ndërtuar besimin, konfidencën dhe vetëvlerësimin e tyre. Ky udhëzues riintegrimi i pajis profesionistët me informacion në lidhje me mentorimin e viktimave të trafikimit gjatë rikuperimit dhe riintegrit të tyre. Udhëzuesi fillon me një përmbledhje të procesit të rikuperimit dhe riintegrit pas një përvoje trafikimi. Më pas vazhdon të shpjegojë modelin e mentorimit dhe rolin e mentorëve në mbështetjen e rikuperimit dhe riintegrit. Ai gjithashtu shpjegon se si të krijohen marrëdhënie mentorimi, faza të ndryshme në procesin e mentorimit dhe sfidat me të cilat përballlet mentorimi. Udhëzuesi përfundon me udhëzimet për mentorët dhe profesionistët e riintegrit kur përdorin një model mentorimi për të mbështetur riintegritin e viktimave të trafikimit.